

Ditar 32

Janar – Qershor 2025

Nr. 32

Datë: 01.07.2025

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Faqe

Shprehje interesi për ngritjen e Komiteteve të Përbashkëta Konsultative me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe me Komitetin e Rajoneve të Bashkimit Evropian.....	2
Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.....	4
Takime informuese dhe konsultime publike me Organizata të Shoqërisë Civile në kuadër të Thirrjes Nr.18.....	4
Mbahet Mbledhja e parë për vitin 2025 e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.....	6
Takimet e Grupit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (GNPIE), për Kapitullin 22.....	7
Takimi Tematik për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.....	9
AMSHC shpall Thirrjen 18 për projekt-propozim.....	10
Shpallet thirrja për propozim të kandidatëve për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).....	11
Progaami i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Kosovë.....	13
Intervistë me z. Ylljet Aliçka- anëtar i Bordit Mbikqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.....	14

Shprehje interesi për ngritjen e Komiteteve të Përbashkëta Konsultative me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe me Komitetin e Rajoneve të Bashkimit Evropian

Tiranë, 23 janar 2025



Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 187, datë 18.09.2024 “Për ngritjen e Komiteteve të Përbashkëta Konsultative (KPK) me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) dhe me Komitetin e Rajoneve të Bashkimit Evropian”, drejton procesin e përzgjedhjes e të emërimit të anëtarëve shqiptarë të KPK me KESE, në bazë të propozimeve të partnerëve socialë dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile.

Për këtë qëllim, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, shpallën “Thirrje për shprehje interesi”, duke ftuar përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për të qenë përfaqësues të palës shqiptare në Komitetin e Përbashkët Konsultativ (KPK) me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (KESE), për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Komiteti i Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian krijohet me detyrën për të ndihmuar Këshillin e Stabilizim-Asociimit, me synimin për të nxitur dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet partnerëve socialë dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile në Bashkimin Evropian dhe në Shqipëri. Një dialog dhe bashkëpunim i tillë do të përfshijë të gjitha aspektet përkatëse të marrëdhënieve ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, siç paraqiten në kontekstin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Dialogu dhe bashkëpunimi i tillë synon veçanërisht:

1. përgatitjen e punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile shqiptare për veprimtari në kuadrin e anëtarësimit të ardhshëm në Bashkimin Evropian;
2. përgatitjen e punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile shqiptare për pjesëmarrjen e tyre në punën e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian pas aderimit të Shqipërisë;
3. shkëmbimin e informacionit për çështjet aktuale me interes të ndërsjellë, veçanërisht mbi rrethanat aktuale të procesit të aderimit, si dhe përgatitjen e punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile për atë proces;
4. inkurajimin e shkëmbimeve të përvojës dhe dialogut të strukturuar ndërmjet punëdhënësve shqiptarë, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile dhe punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile nga shtetet anëtare, duke përfshirë nëpërmjet rrjetëzimit në fusha specifike ku kontaktet dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë mund të rezultojnë të jenë mënyra më efektive e zgjidhjes së problemeve të veçanta;
5. diskutimin e çdo çështjeje tjetër që lind në kontekstin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duke përfshirë në lidhje me procesin e aderimit të Shqipërisë.



Komiteti i Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian do të përbëhet nga gjashtë përfaqësues të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe gjashtë përfaqësues të partnerëve socialë të Shqipërisë dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të marrin pjesë.

Komiteti i Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian do të kryejnë detyrat e tyre në bazë të konsultimit nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit ose, në lidhje me nxitjen e dialogut ndërmjet qarqeve ekonomike dhe sociale, me nismën e tij.

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Tiranë, 13 shkurt 2025



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në mbështetje të nenve 9, 10, 11 e vijues të Ligjit Nr.10 093/2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, organizoi mbledhjen e Bordit Mbikqyrës ditën e enjte, datë 13 Shkurt 2025.

Në mbledhje u trajtuan çështjet e mëposhtme:

1. Miratimi i Raportit Vjetor për vitin kalendarik 2024, përgatitur nga AMSHC për veprimtarinë e saj sipas përcaktimeve që legjislacioni në fuqi bën.
2. Diskutimi mbi politikat përcaktuese të përparësive, që do të mblidhen nga propozimet e OJF-ve në Qarqet e Shqipërisë.
3. Miratimin e përmbajtjes të anketës të përgatitur nga AMSHC për mbledhjen në formë statistikore të të dhënave të OJF-ve për disa shtylla ku bazohet veprimtaria e tyre.

Takime informuese dhe konsultime publike me Organizata të Shoqërisë Civile në kuadër të Thirrjes Nr.18

25 shkurt - 4 prill 2025



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile , dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut si dhe në kuadër të Ligjit Nr. 146/ 2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”;

Procesi i konsultimit publik në kuadër të përcaktimit të prioritetëve mbi thirrjes e radhës në qytete e Shqipërisë si mëposhtë:



- Vlorë në datën 25 Shkurt 2025 Hotel Bologna ora 12:00
- Berat në datën 04 Mars 2025 Hotel AlBon ora 12:00
- Pogradec- Korçë në datën 13 Mars 2025 Hotel Kocibelli ora 12:00
- Kukës në datën 18 Mars 2025 Hotel Gjallica ora 12:00
- Shkodër në datën 25 Mars 2025 Hotel Golden Palace ora 11:00
- Tiranë në datën 3 prill 2025 pranë ambjeteve të AMSHC ora 11:00



Gjithashtu ftoi të gjitha OJF-të e interesuara dhe të pamundura për të qënë pjesë e takimit të dërgojnë në adresën e emailit info@amshc.gov.al të gjitha sugjerimet e tyre në kuadër të prioritetëve mbi shpalljen e thirrjes nr. 18.

Takimet u zhvilluan në një atmosferë konstruktive dhe u karakterizua nga pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve të shoqërisë civile lokale. Diskutimet u fokusuan në:

- Identifikimin e sfidave me të cilat përballen organizatat në terren;
- Nevojën për mbështetje të qëndrueshme institucionale;
- Rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorit civil dhe institucioneve publike;
- Sugjerime konkrete për përmirësimin e politikave mbështetëse.



Pjesëmarrësit vlerësuan organizimin e takimeve dhe shprehën interes për vazhdimësi të këtyre komunikimesh. Të gjitha gjetjet, sugjerimet apo prioritetet janë përmbledhur dhe do përfshihen në shpalljen e thirrjes nr. 18.



Mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 1 Prill 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në funksionin e Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, zhvilloi në datën 1 Prill 2025 në orën 14:00 në ambjentet e Qendrës për Hapje dhe Dialog në Kryeministri, mbledhjen e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.



Nën drejtimin e Z. Vladimir Thanos, Nënkryetar i Këshillit, dhe në prezencë të anëtarëve të qeverisë, të shoqërisë civile, dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, u mbajt mbledhja e parë kombëtare e KKSHC-së për vitin 2025.

Gjatë mbledhjes disa nga çështjet që u diskutuan ishin:

- (i) Problematikat e hasura nga shoqëria civile në kuadër të tkurrjes së burimeve financiare nga donatorët ndërkombëtarë;
- (ii) Efikasiteti i Ligjit për Sponsorizimet;
- (iii) Mbështetja financiare për shoqërinë civile nga



Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.



Takimet e Grupit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (GNPIE), për Kapitullin 22

Tiranë, 24 Prill 2025



Më 23 prill 2025, përfaqësues të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile more pjesë në Sallën Albanologjia të Pallatit të Kongreseve në Tiranë, ku u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (GNPIE) për Kapitullin 22, që i dedikohet politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore të BE-së. Kjo mbledhje mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve kyçe Shqiptare dhe partnerët ndërkombëtarë nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, pjesë e tyre ishin dhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), projekti i asistencës teknike për Kapitullin 22 në Shqipëri, projekti i asistencës teknike EU4GoodGovernance dhe projekti Zviceran “Bashki të Forta”, për të diskutuar mbi ecurinë e procesit të integritit të Shqipërisë në kuadër të këtij kapitulli dhe hapat që duhen ndjekur më tej.



Në fjalën e tij të hapjes së mbledhjes, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe njëherazi negociatori për Kapitullin 22, z. Arbjan Mazniku, theksoi se Shqipëria ndodhet në një moment vendimtar në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian, falë punës së jashtëzakonshme të bërë deri më tani nga secili prej institucioneve të pranishme për përgatitjen e pozicioneve negociuese dhe për të avancuar në procesin e integritimit.

Në vijim, z. Hubert Perr, Drejtor i Bashkëpunimit pranë Delegacionit të BE-së në Shqipëri, në fjalën e tij rikonfirmoi mbështetjen e vazhdueshme të BE-së përmes projekteve të asistencës teknike dhe Planit të Rritjes, nga i cili Shqipëria do të përfitojë një shumë të konsiderueshme prej 922 milionë euro. Ai theksoi gjithashtu që Shqipëria do të përfitojë edhe nga fonde të asistencës IPA për të mundësuar që procesi i integritetit dhe programimit të vazhdojë me sukses.



Zv/Ministri i Financave, z. Andi Memeti, i cili është emëruar së fundmi si Autoriteti Kombëtar i Autorizuar (NAO), theksoi rëndësinë e sigurimit të standardeve të larta të kontrollit financiar dhe administrimit të fondeve në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së.



Në vijim të mbledhjes, Sekretariati Teknik prezantoi Raportin e Shqyrtimit (Screening Report) e dërguar nga Komisioni Evropian për pjesën e Kapitullit 22, duke vënë në dukje progresin e arritur dhe çështjet që mbeten për t'u adresuar.

Ekspertet e asistencës teknike të BE-së, znj. Valeria Valeri dhe znj. Victoria Primhak, ndanë përditësimet mbi Planin e Veprimit si dhe raportet e vlerësimit vetjak të institucioneve përgjegjëse lidhur me përmbushjen e kushteve mundësuese për këtë kapitull. Pjesë e diskutimeve ishte edhe planifikimi i aktiviteteve të GNPIE për periudhën maj-korrik 2025, me qëllim intensifikimin e punës ndërinstitucionale në këtë fazë të rëndësishme të procesit.



Mbledhja shërbeu si një platformë e rëndësishme për të diskutuar progresin, sfidat dhe prioritetet që duhen adresuar në vijim. Të gjithë pjesëmarrësit u angazhuan për një bashkëpunim të ngushtë dhe për koordinim të qëndrueshëm ndërinstytucional për të siguruar që Shqipëria të përmbushë me sukses kërkesat e Kapitullit 22. Ky angazhim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe përdorimit efektiv të fondeve Evropiane.

Takimi Tematik për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit

Tiranë, 24 Prill 2025

Takimi i Ekipit Tematik për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit

Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, në dt. 24 Prill 2025,

u zhvillua takimi i radhës i Ekipit Tematik në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, i drejtuar nga Zv.Ministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta.



Në takim morën pjesë të gjitha institucionet zbatuese të strategjisë, dhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), të angazhuara për një implementim efikas dhe të qëndrueshëm të masave të parashikuara.

Diskutimet u fokusuan në çështje kyçe si:

- ◆ *Ofrimi i ndihmës juridike falas për grupet vulnerabël*
- ◆ *Promovimi i ndërmjetësimit si mekanizëm alternativ dhe i shpejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*
- ◆ *Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit*

Një theks i veçantë iu dha rolit të shoqërisë civile, e cila mbetet partnere e pazëvendësueshme në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen konkrete për viktimat.




✍ *Strategjia është vlerësuar si një arritje thelbësore në kuadër të procesit të integrimit europian, duke reflektuar përkushtimin institucional për ndërtimin e një sistemi drejtësie më gjithëpërfshirës, efikas dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.*

AMSHC shpall Thirrjen 18 për projekt-propozime

Tiranë, 13 Maj 13 Qershor 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në kuadrin e konkurrimit të hapur dhe transparent sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenet 8, 21, 22, 23, të Ligjit Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në nenet 5, 10, të VKM-së 769/2009 “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, e ndryshuar, Vendimit 02 të Bordit Mbikqyrës të datës 14/04/2025 dhe akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi, në përputhje me fushën e saj të veprimtarisë, SHPALL këtë Thirrje për shprehje interesi për aplikime nga ana e OJF-ve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.



Gjatë takimeve të zhvilluara nga përfaqësuesit e AMSHC-së dhe OJF-ve të ndryshme apo pushtetit vendor, janë prezantuar nga ana e institucionit tonë qëllimet e zhvillimit të takimeve dhe janë dëgjuar propozimet e tyre për prioritetet sipas fushës së veprimtarisë dhe në përfundim duke konsultuar në tërësi janë grupuar propozimet për prioritetet. Nga diskutimet e shumta të bëra nga pjesëmarrësit në takime, përfaqësuesit e OJF-ve dhe grupet e tjera të interesit si dhe nga shqyrtimi i të gjithë materialit të marrë në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy), ku pjesëmarrësit listuan të gjitha sugjerimet e tyre, u arrit në përfundim se Shoqëria Civile ndeshet me problematika dhe sfida të shumta, të cilat kërkojnë zgjidhje. Duke marrë parasysh rolin e AMSHC-së në përputhje me ligjin në fuqi pasi u finalizuan takimet e programuara në kuadër të konsultimit publik.



Për të gjitha OJF-të e interesuara që përmbushin kriteret ligjore, jeni të lutur të depozitoni aplikimet tuaja për projekt-propozime sipas fushave prioritare (bashkangjitur) dhe duke depozituar dokumentacionin si më poshtë:

Fushat mbi përparësitë/prioritetet të projekt-propozimeve:

1. Qeverisja e mirë dhe Antikorrupsioni
2. Përfshirje sociale, të drejtat e njeriut dhe fuqizimi i grupeve të marginalizuara
3. Zhvillimi ekonomik, punësimi dhe inovacioni
4. Mbrojtja e mjedisit dhe tranzicioni i gjelbër
5. Kultura, arsimi, shëndeti dhe trashëgimia

Sjellim në vëmendjen tuaj se:

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore që dalin për zbatim të tij për strategji të ndryshme qeveritare, do të konsiderohen me prioritet të gjitha ato projekt-propozime, të cilat kanë në fokus tregues që janë shtylla në Strategjitë e miratuara nga qeveria.

Shpallet thirrja për propozim të kandidatëve për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 26 Maj – 27 Qershor 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në KKShC, për 5 (katër) vendet vakante të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 3-vjeçare, përkatësisht:

- **3 (tre) anëtarë** për fushën e veprimit “A. Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE”
- **2 (dy) anëtarë** për fushën e veprimit “B. Zhvillimi ekonomik, territorial, mjedisor



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI KOMBËTAR
PËR SHOQËRINË CIVILE
COUNCIL OF CIVIL SOCIETY
NATIONAL COUNCIL FOR CIVIL SOCIETY



amshc
Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

Në këtë fazë, ftohen të gjitha organizatat e shoqërisë civile të paraqesin propozimet e tyre për kandidatët duke plotësuar **“FORMULARIN STANDARD TË APLIKIMIT”**– Për propozimin e kandidatëve nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile në KKShC dhe ta dërgojnë me e-mail në adresën **kkshc@amshc.gov.al**, me referencë të saktë të subjektit: **“Propozim Kandidature për KKSHC”**.

Faza e procesit të Propozimit të Kandidatëve anëtarë të KKShC-së është e hapur **nga data 26 maj 2025 deri më 27 qershor 2025**, kohë në të cilën paraqiten kandidaturat dhe dokumentacionet mbështetëse si nga ana e organizatave propozuese të kandidatëve, ashtu edhe nga ana e të kandiduarve. FORMULARI STANDARD I APLIKIMIT dhe gjithë dokumentet mbështetëse të poshtëshënuara duhet t'i dërgoni brenda afatit të përcaktuar, me rrugë elektronike në adresën **kkshc@amshc.gov.al** me postë në adresën:

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
Rruga "Frosina Plaku", Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

KRITERET PËR KANDIDATËT DHE DOKUMENTACIONET MBËSHTETËSE:**1. Dokumentet që duhen dorëzuar nga organizatat që nominojnë kandidatët:**

- Formulari i Aplikimit, i publikuar nga AMSHC
- Kopje e dokumentit të regjistrimit në Gjykatë
- Konfirmim nga zyra e e tatimeve që organizata e ka statusin "aktiv"

2. Kriteret që duhen përmbushur nga kandidatët për KKSHC:

- Të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë në rol drejtues në organizata të shoqërisë civile në fushën ku kandidon
- Të mos ketë role koordinuese ose drejtuese në organizata politike ose parti politike

3. Dokumentet që duhen dorëzuar nga të nominuarit:

- Jetëshkrimi (CV – Curriculum Vitae);
- Letër motivimi nga kandidati për të shpjeguar kontributin që mund të japë pranë KKSHC-së
- Letër konfirmuese nga organizata e shoqërisë civile se kandidati ka të paktën 3 (tre) vite eksperiencë në fushën ku kandidon;
- Pesë letra mbështetëse nga organizata të tjera të cilat mbështesin kandidatin

NOMINIMET DHE PROCEDURA E VOTIMIT:

- Të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile të regjistruara dhe aktive, nominojnë kandidatët e tyre duke pasur parasysh se çdo subjekt **mund të emërojë vetëm një kandidat për anëtar të KKSHC- së.**
- Aplikantëve ju lejohe **një mundësi për të apeluar brenda 3 (tre) ditësh** pas publikimit të listës së nominimeve të vlefshme, në rast se nominimet e tyre janë konsideruar të pavlefshme.
- Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së publikon në faqen e internetit **Thirrje Publike për Votimin** për kandidatët e vlefshëm. Subjektet votojnë për kandidatët nga lista e kandidatëve të përpiluar nga Komisioni Teknik i AMShC-së **duke respektuar parimin që një organizatë mund të votojë vetëm një herë kandidatin e preferuar për secilën për fushë.**
- Komisioni Teknik i AMShC-së vijon më tej me numërimin e votave (në një seancë të hapur dhe transparente) dhe kandidatët me numrin më të madh të votave të vlefshme, shpallen automatikisht si anëtarë të KKSHC-së

Për më shumë informacione vizitoni faqen www.kkshc.gov.al.

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri - Kosovë

Tiranë, 15 Qershor 2025



Në Tiranë, më 15 Qershor 2025, përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile morën pjesë në mbledhjen e dytë të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit të Programit IPA III Shqipëri-Kosovë. Komiteti miratoi unanimisht dokumentet kryesore, përfshirë notën konceptuale për thirrjen e parë për propozime, planin e punës për periudhën 2025–2026, si dhe planin e vizibilitetit dhe komunikimit.

🇷🇺 🇧🇪 Anëtarët vlerësuan përputhshmërinë e programit me prioritetet strategjike të BE-së, Agjendën e Gjelbër, Planin e Zhvillimit për Ballkanin Perëndimor dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Drejtoresha e Përgjithshme, znj. Eridana Çano, theksoi rolin udhëheqës të Shqipërisë në zbatimin e programit, si dhe angazhimin për integrim rajonal dhe zhvillim të qëndrueshëm.



🇧🇪 Programi synon të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar përmes zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit, turizmit të qëndrueshëm dhe rritjes së mundësive për të rinjtë. Ai përfaqëson një vizion të përbashkët për një rajon më të lidhur, më të qëndrueshëm dhe më të begatë, duke dëshmuar se me mbështetje politike, përfshirje të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është ura më e sigurt drejt integritetit evropian.

Intervistë me Z. Ylljet Aliçka



Një zë i fuqishëm i mendimit kritik, diplomacisë dhe kulturës shqiptare

Shkrimtar, diplomat dhe anëtar i Bordit Mbikëqyrës të AMShC-së, Ylljet Aliçka është një nga figurat më të gjithanshme të jetës publike në Shqipëri.

Ylljet Aliçka lindi në Tiranë më 23 qershor 1951 dhe është një emër i konsoliduar në letrat shqipe, diplomaci dhe shoqëri civile. Me një karrierë që shtrihet në mbi katër dekada, ai ka ndikuar thellësisht në formësimin e diskursit shoqëror dhe kulturor në vend.

 *Shkrimtari i ironisë fine*

Aliçka është autor i veprave letrare të spikatura, si:

Parullat me gurë (1997)

Kompromisi (2000)

Valsi i lumturisë (2012)

Një rrëfenjë me ndërkombëtarë – një roman satirik që hedh dritë mbi raportin kompleks mes shoqërisë shqiptare dhe ndërkombëtarëve në periudhën e tranzicionit.

Veprat e tij janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë përdorur si bazë për filma artistikë me sukses ndërkombëtar, ndër të cilët më i njohuri është Slogans, i shfaqur në Festivalin e Kanës dhe i vlerësuar me çmime të rëndësishme.

 *Akademik dhe profesor*

Me formim shkencor në fushën e didaktikës, Aliçka është mbajtur për dekada si një zë i rëndësishëm në edukim. Ka dhënë mësim në Universitetin European të Tiranës, Universitetin Mesdhetar dhe në Universitetin e Arteve, ku ka trajtuar tema që lidhen me komunikimin ndërkulturor dhe artin bashkëkohor.

 *Diplomat i kulturës*

Në periudhën 2007–2013, Ylljet Aliçka ka shërbyer si Ambasador i Shqipërisë në Francë, Portugal, Monaco dhe pranë UNESCO-s. Gjatë kësaj kohe, ai përfaqësoi vendin në forume të rëndësishme të Frankofonisë, duke e vendosur Shqipërinë në qendër të vëmendjes kulturore ndërkombëtare.

Zë aktiv për shoqërinë civile

Aktualisht, z. Aliçka është anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), ku angazhohet për forcimin e rolit të OJF-ve dhe pjesëmarrjes qytetare në jetën publike. Përvoja e tij si autor dhe diplomat i jep një qasje të thellë dhe të balancuar ndaj sfidave që has sektori i shoqërisë civile në vend.

◆ Me një stil të veçantë narrativ, që ndërthur ironinë, përvojën institucionale dhe ndjeshmërinë qytetare, Ylljet Aliçka mbetet një figurë e respektuar që i ka dhënë kulturës shqiptare një zë unik dhe të guximshëm.

*Pas këtij prezantimi, kemi kënaqësinë të ndajmë me lexuesit një **intervistë ekskluzive** me z. Aliçka, ku ai ndan pikëpamjet e tij mbi zhvillimet më të fundit në sektorin e shoqërisë civile, prioritetet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe rolin që luajnë organizatat në jetën demokratike të vendit. Më poshtë gjeni të plotë qëndrimin e tij.*

Faleminderit që më dhatë mundësinë për tu shprehur për një temë kaq të rëndësishme e të ndjeshme për shoqërinë e sotme, atë të shoqërisë civile, që ndryshe, krahas pushteti legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor, ka marrë tashmë statusin e fuqisë së katërt.

Natyrisht dhe për mua shoqëria civile përfaqëson një komponent thelbësor të jetës demokratike dhe zhvillimit shoqëror, qoftë kjo në formën e një organizate, grupi apo dhe individësh që veprojnë jashtë sektorit shtetëror dhe atij privat për të përfaqësuar interesat e komuniteteve, për të mbrojtur të drejtat dhe për të nxitur pjesëmarrjen qytetare.

Falë përvojës sime pranë Komisionit europian i ngarkuar me disa projekte të shoqërisë civile, prej tri vitesh jam zgjedhur antar i Bordit të AMSHC. Kam mendimin se tipari i funksionimit të këtij Bordi ka qenë pavarësia, transparencja dhe pjesëmarrja. Sipas parimit se për të funksionuar në mënyrë efektive, shoqëria civile duhet të jetë e pavarur nga shteti dhe sektori privat, të ketë burime të qëndrueshme financimi dhe të ruajë lirinë për të vepruar dhe shprehur mendimet. Gjithashtu, transparencja dhe llogaridhënia e tyre pranë AMSHC janë thelbësore për të ruajtur besimin e publikut, përmes raportimeve të rregullta dhe aksesit të hapur në informacion.

Sado kompleks qoftë, roli i saj është vendimtar, në garantimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, duke forcuar kështu kohezionin social dhe demokracinë.

Eshtë kjo shoqëri civile e cila shërben si një urë lidhëse midis qytetarëve dhe institucioneve publike, duke përfaqësuar interesat e grupeve të ndryshme, veçanërisht të atyre të marginalizuar. Pa harruar rolin e saj kritik në mbikëqyrjen e pushtetit politik, në nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe socializimit politik, si dhe në zhvillimin social dhe ekonomik.

AMSHC-ja e konsideron shoqërinë civile një partner strategjik në përmbushjen e objektivave të zhvillimit dhe programeve të integritetit evropian të Shqipërisë, me synim mbrojtjen e hapësirës së shoqërisë civile, mbështetjen ndaj aktorëve të kërcënuar për shkak të angazhimit të tyre dhe ndihmën në forcimin e kapaciteteve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Unë do e konsideroja të rëndësishëm dhe një tjetër funksion të saj, atë të ndërmjetësimit në

konfliktet sociale dhe lehtësimi i dialogut midis aktorëve të ndryshëm, parime këto që përbëjnë dhe boshtin e funksionimit të AMSHC.

Në formë më të thjeshtë do përmendja në formë më të përmbledhur disa nga këto parime:

-Pjesëmarrja e qytetarëve në çështjet publike, gjë që realizohet përmes:

- *Fushatave ndërgjegjësuese*
- *Aktivitetit vullnetar*
- *Formimit të grupeve të punës kolektive*

- Pavarësia e shoqërisë civile nga shteti

Shoqëria civile duhet të jetë autonome dhe e pavarur nga shteti dhe sektori privat për të funksionuar në mënyrë efektive. Kjo do të thotë:

- *Qeverisje e brendshme e pavarur*
- *Burime të financimit të larmishme*
- *Liri për të shprehur mendimet dhe për të vepruar pa ndërhyrje të tepruar*

- Transparenca dhe përgjegjshmëria

Transparenca dhe përgjegjshmëria janë elemente kyçe që shoqëria civile të ruajë besimin e publikut. Kjo nënkupton:

- *Raportim të rregullt për aktivitetet e tyre*
- *Vendosjen e mekanizmave të kontrollit për veprimtarinë*
- *Sigurimin e një qasjeje të lehtë në informacionin financiar dhe operacional*

- Bashkëpunimi me aktorë të tjerë, përfshirë qeveritë dhe sektorin privat, është thelbësor për të maksimizuar ndikimin e shoqërisë civile. Partneritetet ndihmojnë për:

- *Zgjerimin e qasjes në burime*
- *Rritjen e efikasitetit përmes ndarjes së aftësive dhe njohurive*
- *Kapërcimin e sfidave komplekse nëpërmjet punës së përbashkët*

Një studim i thelluar mbi partneritetet tregon se organizatat e shoqërisë civile që angazhohen në bashkëpunime ndërkufitare arrijnë më shpesh qëllime globale për ndryshim shoqëror në mënyrë më efektive. Kjo vjen pjesërisht nga aftësia për të ndarë burime dhe ide në nivel ndërkombëtar — gjë që shpesh nuk është e realizueshme për një organizatë që vepron e vetme.

- Shoqëria civile është thelbësore për mbështetjen dhe forcimin e demokracisë. Ajo vepron përmes:

- *Inkurajimit të pjesëmarrjes qytetare*
- *Promovimit të të drejtave të njeriut*
- *Mbikëqyrjes së proceseve zgjedhore*

- Avokimi për ndryshim shoqëror

Shoqëria civile është një zë i fuqishëm në mbrojtjen e kauzave të rëndësishme shoqërore.

Përmes fushatave avokuese dhe iniciativave ndërgjegjësuese, ajo mund të:

- *Hedhë dritë mbi padrejtësitë sociale*
- *Inkurajojë reforma ligjore*
- *Mobilizojë burime për kauza të caktuaraDuke vepruar në këtë mënyrë, ajo ndikon drejtpërdrejt në evolucionin e normave shoqërore.*

Në fushën e qeverisjes dhe politikës, shoqëria civile vepron si një kundër-pushtet duke:

- *Promovuar transparencën dhe përgjegjësinë e qeverisë*
- *Inkurajuar pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse*
- *Mbikëqyrur zbatimin e ligjeve dhe politikave publike*

Kjo përgjegjësi aktive ndihmon për të ruajtur një ekuilibër të shëndetshëm midis pushtetit publik dhe të drejtave të qytetarëve.

Një shembull i kontributit të shoqërisë civile në qeverisje ka qenë dhe mbetet roli i vëzhguesve zgjedhorë, të cilët monitorojnë integritetin e proceseve zgjedhore.

- Shoqëria civile dhe angazhimi komunitar

Ndikimi i shoqërisë civile në angazhimin komunitar është ka gjallëruar ndjeshëm dhe mobilizuar grupet lokale për kauza të ndryshme. Disa mënyra të angazhimit kanë përfshirë:

- *Organizimin e programeve të shërbimeve komunitare*
- *Krijimin e platformave për dialog dhe shkëmbim komunitar*
- *Lehtësimin e punës vullnetare dhe iniciativave vendore*

Këto aktivitete forcojnë kohezionin social dhe inkurajojnë qytetarët të marrin pjesë aktivisht në zhvillimin e komunitetit të tyre.

- Strategjitë inovative

Duke shqyrtuar më nga afër angazhimin komunitar, vërejmë se grupet e shoqërisë civile kanë zhvilluar strategji inovative, si përdorimi i rrjeteve sociale për të forcuar mesazhin e tyre dhe për të rritur pjesëmarrjen.

Përmes fushatave digjitale dhe platformave interaktive, ata arrijnë një audiencë më të re, shpesh më e vështirë për t'u angazhuar përmes mjeteve tradicionale.

Kjo dixhitalizim e angazhimit ka sjellë një përf forcim të ndjeshëm të zërave komunitarë, duke transformuar mënyrën se si lëvizjet shoqërore organizohen dhe funksionojnë sot.

Duke përqafuar teknologjinë, shoqëria civile jo vetëm që ndjek tendencat moderne, por formëson aktivisht një të ardhme pjesëmarrëse të bazuar në përfshirjen digjitale.

Përvoja ka dëshmuar se organizatat e shoqërisë civile shpesh reagojnë më shpejt se shteti ndaj nevojave shoqërore përmes projekteve në arsim, shëndetësi dhe mbështetje ndaj shtresave në nevojë.

- Zhvillimi i qendrueshëm

Një tjetër aspekt apo parim i funksionimit të Bordit të AMSHC ka qenë nxitja e shoqërisë civile në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo përfshin angazhimin për çështje mjedisore, drejtësi sociale dhe standarde etike ekonomike. Ajo shtyn sektorët e tjerë të shoqërisë të adoptojnë praktika më të përgjegjshme dhe ekologjike të qëndrueshme, duke ndihmuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për brezat e ardhshëm.